



Jedinstvena Srpska Lista

Pasqyrat Financiare Vjetoredhe Raporti i Auditorëve të pavarur

01 Janar 2013 - 31 Dhjetor 2013

Përmbajtja:

<u>Raport i auditorëve të Pavarur.....</u>	<u>3</u>
Pasqyra e Pozitës Financiare.....	6
Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve.....	7
Shënimet e pasqyrave financiare.....	8-10

Raport i Auditorëve te pavarur

Drejtuar Kryesisë së Jedinstvena Srpska Lista

Raport mbi Pasqyrat Financiare për qëllime specifike

Mohim i opinionit

Ne kemi qenë të angazhuar për të audituar raportet financiare të bashkëngjitura të Subjektit politik Jedinstvena Srpska Lista (në vijim referuar si “Subjekti Politik” apo “JSL” apo “SP”), të përbëra nga pasqyra e Pozitës Financiare me 31 Dhjetor 2013, pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën e përfunduar me këtë datë, dhe informacionin tjetër shpjegues të përfshira në fq. 6-13.

Prandaj, ne nuk shprehim një opinion mbi raportet financiare të subjektit Jedinstvena Srpska Lista. Për shkak të rëndësisë së çështjeve të përshkruara në paragrafin bazat për mohim të dhënies së opinionit, ne nuk kemi qenë në gjendje të sigurojmë evidencën e nevojshme të auditimit për të paturnjë bazë për një opinion të auditimit.

Bazat për mohim të Opinionit

- Subjektin Politik nuk kemi mundur ta kontaktojmë .Ne mungese të librave kontabël dhe shënimeve të mirëfillta ne e kishim të pamundur aplikimin e procedurave të auditimit ashtu siç kërkohet me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit.
- Ne mungese të dokumentacionit mbështetës ne e kishim të pamundur të verifikojmë nëse asetet, detyrimet dhe ekuiteti i deklaruar pasqyrojnë drejt gjendjen SP me 31 Dhjetor 2013.
- Subjekti politik nuk ka dorëzuar ne KQZ kopjet e faturave mbi shpenzimet e raportuara ashtu siç kërkohet me ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar. Ne mungese të dokumentacionit mbështetës ne e kishim të pamundur të verifikojmë nëse shpenzimet e raportuara janë të sakta dhe prezantojnë drejt aktivitetin e SP.
- Subjekti Politik nuk ka prezantuar të hyra dhe shpenzime për vitin krahasues 2012 ashtu siç kërkohet me ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar, edhe pse SP ka zhvilluar aktivitetet përgjatë këtij viti.
- Subjekti politik nuk ka dorëzuar ne KQZ raportin bankar për periudhën 01 Janar 2013 deri me 31 Dhjetor 2013 ashtu siç kërkohet me ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin

dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar. Ne mungese te dokumentacionit mbështetës ne e kishim te pamundur te verifikojmë nëse gjendja e bankës e raportuar është e sakte dhe njëkohësisht nëse te hyrat dhe shpenzimet e raportuar prezantojnë drejt aktivitetin e raportuar të SP.

- Ne mungese te konfirmimeve nga bankat ne e kishim te pamundur te verifikojmë nëse SP ka vetëm një llogari bankare ashtu siç kërkohet me ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 11, paragrafi 3.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre te ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së subjektit politik për të vazhduar aktivitetin e saj(parimi i vijimësisë), shpалosjen, sipas rastit, te çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës se kontabilitet sipas parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Subjektin Politik ose të ndërpresë operationet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të

këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.

- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Audit & Conto sh.p.k

Muhamet Feka
Auditor Ligjor
29 Nëntor 2017

Pasqyra e Pozitës Financiare

Pasuritë		Me 31 Dhjetor 2013	Me 31 Dhjetor 2012
Pasuritë afatgjata	Shënimi	Shuma në Euro	Shuma në Euro
Toka, objektet dhe pajisjet			
Pasuritë e paprekshme			
Pasuritë tjera afatgjata			
Total pasuritë afatgjata		0.00	0.00
Pasuritë afatshkurtra			
Llogaritë e arkëtueshme		0.00	0.00
Parapagimet			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë			
Pasuritë tjera afatshkurtra			
Total pasuritë afatshkurtra			
Total pasuritë			
Ekuiteti			
Fondet e akumuluar			
Suficiti / (deficiti) i vitit		42,500.90	0.00
Total Ekuiteti		42,500.90	0.00
Detyrimet			
Detyrimet afatgjata			
Huatë e pagueshme			
Të hyrat e shtyera			
Gjithsej detyrimet afatgjata			
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera			
Detyrimet tjera afatshkurtra			
Gjithsej detyrimet afatshkurtra			
Gjithsej detyrimet			
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		42,500.90	0.00

Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve

	Shënimi	Viti që përfundon me 31 Dhjetor	
		2013	2012
Të hyrat			
Të hyrat nga buxheti		70,000.00	
Të hyrat nga anëtarësia			
Donacionet dhe kontributet në të holla		0.00	
Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime			
Të hyrat e fushatës			
Te hyrat e liruar nga te hyrat e shtyera		0.00	
Të hyrat tjera			
Gjithsej të hyrat për vitin		70,000.00	0.00
Shpenzimet			
Pagat dhe kompensimet	2	0.00	
Shpenzimet e transportit	2	9,368.19	
Reklammat, reprezentacioni dhe konferencat	2	6,137.41	
Shpenzimet e fushatës	2	0.00	
Blerja e mallrave	2	2,823.50	
Shpenzimet e përgjithshme	2	6,650.00	
Shpenzimet e ndryshme	2	2,520.00	
Gjithsej shpenzimet për vitin		27,499.10	0.00
Suficiti / (deficiti) për vitin		42,500.90	0.00

1. Informata te përgjithshme

Jedinstvena Srpska Lista është subjekt juridik i certifikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Adresa e Subjektit Politik: Gracanica

Adresa:Gjilan

Kryetar:Sreten Ivanoviq

Pasqyrat financiare te Jedinstvena Srpska Lista janë përgatitur sipas kërkesave te Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar.

Shënimi 2: Shpenzimet

Shpenzimet	Shpenzimi në Euro	Pagesa në Euro	Borxhi i mbetur në Euro
Pagat dhe kompensimet			
Pagat dhe kompensimet, neto			0.00
Kontributet pensionale të punëmarrësit			0.00
Kontributet pensionale të punëdhënësit			0.00
Tatimet në të ardhura personale			0.00
Beneficionet tjera			0.00
Gjithsej			0.00
Shpenzimet e transportit			
Automjetet motorike të huazuara	6,900.00	6,900.00	0.00
Karburantet	2,368.19	2,368.19	0.00
Biletat, aeroplanit/autobusit/trenit/taksit etj.			0.00
Sigurimi dhe mirëmbatja e veturave			0.00
Çdo shpenzim tjetër i transportit	100.00	100.00	0.00
Gjithsej shpenzimet e transportit	9,368.19	9,368.19	0.00
Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat			
Lokali			0.00
Ushqimi	1,187.41	1,187.41	0.00
Aktivitete kulturore dhe rekreative			0.00
Radio dhe spotet televizive			0.00
Stendat e afishmit dhe reklamimet në gazeta			0.00
Shpenzimet tjera të reklamave, reprezentacionit dhe konferencave	4,950.00	4,950.00	0.00
Gjithsej reklamat, reprezentacioni dhe konferencat	6,137.41	6,137.41	0.00
Shpenzimet e fushatës			
Shpenzimet e fushatës			0.00
Gjithsej shpenzimet e fushatës	0.00	0.00	0.00

Blerja e mallrave			
Furnizimi i zyrës	1,425.50	1,425.50	0.00
Pajisjet të vogla	1,398.00	1,398.00	0.00
Gjithsej blerja e mallrave	2,823.50	2,823.50	0.00
Shpenzimet e përgjithshme			
Qiraja e lokalit të zyrës	6,600.00	6,600.00	0.00
Telefoni, interneti dhe posta	50.00	50.00	0.00
Rryma, shërbimet komunale (uji dhe mbeturinat)			0.00
Shpenzimet e zhvlerësimit të pasurisë afatgjatë			
Shpenzimet lidhur me donacionet dhe kontributet në natyrë në mallra dhe shërbime			
Gjithsej shpenzimet e përgjithshme	6,650.00	6,650.00	0.00
Shpenzimet e ndryshme			
Mirëmbajtja e pajisjeve dhe hapësirave të zyrës	2,520.00	2,520.00	0.00
Shpenzimet që nuk janë përfshirë në asnjë kategori tjetër			0.00
Gjithsej shpenzimet e ndryshme	2,520.00	2,520.00	0.00
Gjithsej shpenzimet	27,499.10	27,499.10	0.00